



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**NR. 40, DATË 31 / 03 / 2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT PREJ 269,213,920 LEKË TË PËRFITUAR NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR NGA FONDI I RINDËRTIMIT I BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2021**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, VKM-së nr.24 dt.20.1.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Tiranë dhe Durrës”, VKM-së nr.98 dt.17.2.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit në Bashkinë Durrës”, VKM-së nr.130 dt.3.3.2021 “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në Bashkinë Durrës”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit nr. 22. dt. 30.07.2018 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2021”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit, zëvendëskryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak Durrës,

**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDOSI**

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 269,213,920 lekë të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit për vitin 2021, si më poshtë vijon:

Nr.	VKM që ka miratuar fondin	Gr.	Kap	Programi	Llog. ekon	Kodi i produktit	Emërtimi i projektit	Fondi në lekë
-----	---------------------------	-----	-----	----------	------------	------------------	----------------------	---------------

1	NR.24 DT.20.01.2021	00	1	04960	606	94902AB	Rikonstruksion /riparim i banesave individuale , i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta dhe njësisive të banimit.	104,150,000
2	NR.98 DT.17.02.2021	00	1	04960	231	94902AE	Sistemim i territorit , lirim i sheshit dhe kthimi i siperfaqes në kuotë për ndërtimin e 44 njësisive të banimit në NJA Ishëm, Bashkia Durrës	53,674,923
3		00	1	04960	231	94902AE	Mbikqyrje	1,237,458
4		00	1	04960	231	94902AE	Kolaudim	185,619
5	NR.130 DT.3.03.2021	00	1	04960	606	94902AC	Financimi i rindertimit të banesave individuale për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rindertimit , banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.	109,965,920
<b>TOTALI</b>								<b>269,213,920</b>

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e shërbimeve publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**




**SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK**


**Dorina Milja**

*Me propozim dhe me miratim,*

*Almendra Raesh*



**U shpall sot më datë 01.04.2021**



2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 247 / prot.  
18

Durrës, më 02.04.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 40 datë 31.03.2021 “Për përdorimin e fondit prej 269,213,920 lekë të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga fondi i rindërtimit i buxhetit të shtetit të vitit 2021”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**ROLAND NASTO**

